

VENDIM
Nr. 27, datë 21.1.2026

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË MALLRAVE, QË MUND TË PËRDOREN OSE
NUK KANË PËRDORIM TJETËR PËRVEÇ QËLLIMIT TË DËNIMIT ME
VDEKJE, TORTURËS OSE DËNIME, APO TRAJTIME MIZORE, ÇNJERËZORE
OSE POSHTËRUESE, TË CILAT JANË OBJEKT I KONTROLLIT SHETËTËROR
TË TRANSFERIMEVE NDËRKOMBËTARE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 5, 9, pika 5, e 13, pika 6, të ligjit nr. 27/2023, “Për kontrollin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së mallrave, që nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare.

2. Miratimin e listës së mallrave, që mund të përdoren për qëllime torture ose ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare.

3. Miratimin e listës së mallrave, që mund të përdoren për dënimin me vdekje, sipas shtojcës nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare.

4. Vendimi nr. 806, datë 28.12.2023, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës të mallrave, që mund të përdoren ose nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA I

**LISTA E MALLRAVE, TË CILAT NUK KANË PËRDORIM TJETËR PËRVEÇ
QËLLIMIT TË DËNIMIT ME VDEKJE, TORTURËS OSE DËNIME, APO TRAJTIME
MIZORE, ÇNJERËZORE OSE POSHTËRUESE**

Shënim hyrës

Kodet “NK” në këtë shtojcë u referohen kodeve të specifikuar në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, bazuar në Sistemin e Harmonizuar Doganor.

¹ Ky vendim është përafuar plotësisht me rregulloren (BE) 2025/928 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 maj 2025, i cili ndryshon rregulloren 2019/125, “Për tregtinë e mallrave të caktuara, të cilat mund të përdoren për dënim me vdekje, torturë apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”, të ndryshuar. Numri CELEX 32025R0928, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, 2025/928, nr. 30. 2025/928, datë 31.7.2025, f. 1–57.

Në rastin kur pjesa “ex” paraprin kodin “NK”, mallrat e përshkruar në këtë shtojcë përbëjnë vetëm një pjesë të fushës së veprimit të kodit “NK” dhe përcaktohen, si nga përshkrimi në këtë shtojcë edhe nga fusha e veprimit të kodit “NK”.

Shënime:

1. Artikujt 1.3 dhe 1.4 në seksionin 1, që kanë të bëjnë me mallrat e përgatitur për ekzekutimin e qenieve njerëzore nuk përfshijnë mallrat mjekësore-teknike.

2. Objekti i kontrolleve në këtë shtojcë nuk duhet të përjashtojë eksportet e mallrave të palistuara (përfshirë bimët), që përmbajnë një ose më shumë prej pjesëve të listuara, kur pjesa ose pjesët e kontrolluara janë elementi kryesor i mallrave dhe mund të hiqen ose të përdoren praktikisht për qëllime të tjera.

NB: Në vlerësimin, nëse pjesa ose pjesët e kontrolluara duhet të konsiderohen si elementi kryesor, është e nevojshme të peshohen faktorët e sasisë, vlerës dhe njohuritë teknologjike të përfshira, si edhe rrethana të tjera të veçanta, të cilat mund ta klasifikojnë pjesën ose pjesët e kontrolluara, si elementin kryesor të mallrave që po merren.

Kodi NK	Përshkrimi
	1. Mallrat e disenjuar për ekzekutimin e qenieve njerëzore, si më poshtë:
ex 4421 90 97 ex 8208 90 00	1.1. Trekëmbësh, gijotina dhe tehet për gijotinat.
ex 8543 70 90 ex 9401 79 00 ex 9401 80 00 ex 9402 10 00	1.2. Karrige elektrike për ekzekutimin e qenieve njerëzore.
ex 9406 20 00 ex 9406 90 38 ex 9406 90 90	1.3. Struktura hermetike, të bëra për shembull prej çeliku dhe xhami, të ndërtuara për ekzekutimin e qenieve njerëzore me anë të përdorimit të një gazi ose substancë vdekjeprurëse.
ex 8413 81 00 ex 9018 90 50 ex 9018 90 60 ex 9018 90 84	1.4. Sisteme automatike për injektimin e ilaçit të përgatitura për ekzekutimin e qenieve njerëzore, me anë të përdorimit të një substancë kimike vdekjeprurëse.
	2. Mallrat, të cilat nuk janë të përshtatshme që të përdoren nga autoritetet ligjzbatuese për të kufizuar qeniet njerëzore, si më poshtë:
ex 8543 70 90	2.1. Pajisjet elektrohok, të cilat synohen që të mbahen në trup nga një person i kufizuar, të tillë si: rripat, mëngët dhe prangat, të ndërtuara për kufizimin e qenieve njerëzore, nën përdorimin e shokëve elektrikë.
ex 7326 90 98 ex 7616 99 90 ex 8301 50 00 ex 3926 90 97 ex 4203 30 00 ex 4203 40 00 ex 4205 00 90 ex 4017 00 00	2.2. Pranga për gishtat e mëdhenj, pranga për gishtat, morsat për gishtat e mëdhenj dhe morsat për gishtat. Shënim. Ky artikull përfshin, si prangat dhe morsat e dhëmbëzuar, ashtu edhe ata të padhëmbëzuar.
ex 7326 90 98 ex 7616 99 90 ex 8301 50 00 ex 3926 90 97 ex 4203 30 00 ex 4203 40 00 ex 4205 00 90 ex 6217 10 00 ex 6307 90 98 ex 4017 00 00	2.3. Pranga me shufra, kufizues të rëndë për këmbët dhe zinxhirë gruporë, që përfshijnë prangat me shufra ose kufizuesit e rëndë për këmbët. Shënime: 1. Prangat me shufra janë pranga ose unaza kyçesh të këmbëve, të pajisura me një mekanizëm kyçjeje, të lidhura me një shufër të ngurtë, zakonisht metalike. 2. Ky artikull përfshin prangat me shufra dhe kufizuesit e rëndë të këmbëve, që lidhen me prangat e zakonshme të duarve përmes një zinxhiri.
ex 7326 90 98 ex 7616 99 90 ex 8301 50 00 ex 3926 90 97	2.4. Zinxhirë gruporë. Shënim. Zinxhirët gruporë përbëhen nga disa palë pranga duarsh, pranga këmbësh, zinxhirë barku ose një kombinim i këtyre, të lidhura me një zinxhir të vetëm (shpesh metalik), duke kufizuar disa persona së bashku në një zinxhir.

ex 4203 30 00 ex 4203 40 00 ex 4205 00 90 ex 6217 10 00 ex 6307 90 98 ex 7315 81 00 ex 7315 82 00 ex 7315 89 00 ex 4017 00 00	
ex 7326 90 98 ex 7616 99 90 ex 7315 81 00 ex 7315 82 00 ex 7315 89 00	2.5. Hekura këmbësh. Shënim. Hekurat e këmbëve janë unaza metalike jo të rregullueshme ose kufizues të tjerë metalikë jo të rregullueshëm, të fiksuar rreth kyçeve të këmbëve të një të burgosuri, zakonisht me anë të një buloni ose sistemi vidhosjeje. Ato mund të jenë me menteshë ose pa menteshë dhe zakonisht lidhen me një zinxhir. (Ato dallohen nga prangat e këmbëve që mund të rregullohen në kyçin e një të ndaluar shtojca II 1.3.)
sh 7326 90 98 ex 7616 99 90 ex 8301 50 00 ex 3926 90 97 ex 4203 30 00 ex 4203 40 00 ex 4205 00 90 ex 6217 10 00 ex 6307 90 98 ex 4017 00 00	2.6. Pranga për kufizimin e qenieve njerëzore, të disanjuara për t'u fiksuar në mur, dysHEME ose tavan.
ex 9401 61 00 ex 9401 69 00 ex 9401 71 00 ex 9401 79 00 ex 9401 80 00 ex 9402 10 00	2.7. Karrige kufizuese: karrige të pajisura me pranga ose pajisje të tjera kufizuese për të kufizuar një qenie njerëzore. Shënim. Ky artikull nuk ndalon karriget e pajisura vetëm me rripa ose breza.
ex 9402 90 00 ex 9403 20 80 ex 9403 50 00 ex 9403 60 00 ex 9403 89 00	2.8. Panele dhe shtretër kufizimi: panele dhe shtretër të pajisur me pranga ose mjete të tjera për të kufizuar një qenie njerëzore. Shënim. Ky artikull nuk ndalon panelet dhe shtretërit e pajisur vetëm me rripa ose breza.
ex 9402 90 00 ex 9403 50 00 ex 9403 60 00 ex 9403 70 00 ex 9403 89 00	2.9. Shtretër kafaz: shtretër të përbërë nga një kafaz (katër anë dhe një tavan) ose strukturë e ngjashme, ku kufizohet një qenie njerëzore brenda krevatit, tavanit ose njërës ose më shumë anëve, të cilat janë të pajisura me shufra metalike ose të tjera dhe që mund të hapen vetëm nga jashtë.
ex 9402 90 00 ex 9403 20 20 ex 9403 50 00 ex 9403 60 90 ex 9403 70 00 ex 9403 89 00	2.10. Shtretër me rrjetë: shtretër të përbërë nga një kafaz (katër anë dhe një tavan) ose strukturë e ngjashme, ku kufizohet një qenie njerëzore brenda krevatit, tavanit ose njërës ose më shumë anëve, të cilat janë të pajisura me rrjetë dhe që mund të hapen vetëm nga jashtë.
ex 6505 00 10 ex 6505 00 90 ex 6506 91 00 ex 6506 99 10 ex 6506 99 90 ex 6217 10 00 ex 6307 90 98	2.11. Kapuçë dhe lidhëse sysh (blindfolds), të disanjuara vetëm për qëllime të zbatimit të ligjit për të bllokuar shikimin dhe/ose për të mbuluar fytyrën e një personi/të ndaluar, duke përfshirë këto kapuçë dhe lidhëse sysh kur lidhen me një zinxhir me pranga të zakonshme ose me kufizues të tjerë. Shënim. Ky artikull nuk përfshin kapuçat për të pështyrë, të cilët kontrollohen në shtojcën II, pika 1.4.
	3. Pajisje portative, të cilat nuk janë të përshtatshme për përdorim nga autoritetet ligjzbatuese për qëllimin e kontrollit të revoltave ose vetëmbrojtje, si më poshtë:
ex 9304 00 00	3.1. Shkopinj ose shufra të bëra prej metali ose materiali tjetër, me një bosht të pajisur me gjemba metalikë.
ex 7326 90 98 ex 4205 00 90 ex 6602 00 00 ex 7326 90 98 ex 7806 00 80 ex 4203 29 90 ex 4015 19 00	3.2. Shkopinj të rënduar ose shkopinj të mbështjellë me lëkurë ose gomë të trashë me peshim shtesë, të disanjuar për të rritur ndikimin kinetik mbi objektivin, si dhe doreza të rënda ose pajisje të tjera të ngjashme. Shënime: 1. Shkopi i rënduar: një pajisje e sheshtë e përbërë nga çelik pranveror i mbështjellë me lëkurë ose gomë të trashë, e përdorur për goditjen ose rrahjen e një personi; ose një shkop i shkurtër i përbërë nga çelik pranveror i mbështjellë me lëkurë, ndonjëherë i rënduar në një skaj me plumb, dhe i përdorur për të goditur një person.

	2. Dorezat e rënda zakonisht janë prej lëkure dhe kanë pluhur çeliku ose plumbi të qepur në material mbi nyje, gishta ose pjesën e pasme të dorës.
ex 4421 91 00 ex 4421 99 99 ex 3926 90 97 ex 6602 00 00	3.3. Lathi Shënim. Lathis janë shkopinj të gjatë dhe fleksibël (mbi 1 m të gjatë), tradicionalisht prej druri ose bambuje, por gjithashtu edhe prej polikarbonati, të përdorur si armë nga oficerët e policisë.
ex 3926 90 97 ex 7326 90 98	3.4. Mburoja me gjemba metalikë.
ex 3926 20 00 ex 7326 90 98 ex 7616 99 90 ex 4017 00 00	3.5. Jelekë mbrojtës me gjemba ose dhëmbëzime, të bëra prej metali ose materiali tjetër të fortë. Shënim. Ky artikull nuk kontrollon jelekët mbrojtës me sisteme mbajtëse ngarkese që përmbajnë pjesë të bëra prej metali ose materiali tjetër të fortë, të përdorura për të fiksuar ose mbajtur pajisje.
	4. Kamxhikët, si më poshtë:
ex 6602 00 00	4.1. Kamxhikë të përbërë nga disa fshikuj ose rripa, si për shembull kamxhikët tufë ose “me nëntë fije”.
ex 6602 00 00	4.2. Kamxhikë me një ose më shumë fshikuj ose rripa, të pajisur me grepë, gjemba, tela metalikë ose objekte të tjera të ngjashme që rrisin ndikimin e goditjes.
ex 6602 00 00	4.3. “Sjamboks” (kamxhik i rëndë). Shënim. Ky artikull i referohet një tipi kamxhiku të rëndë, tradicionalisht prej lëkure, ose prej materialesh të tjera, si plastika. Ky artikull nuk përfshin veglat që përdoren tradicionalisht për drejtimin e kafshëve (barinjtë).
	5. Armë dhe pajisje për shpërndarjen e substancave çorientuese ose irrituese apo projekte ndikimi dhe municion i lidhur me to, të cilat nuk janë të përshtatshme për përdorim nga autoritetet ligjzbatuese për kontrollin e trazirave ose për vetëmbrojtje:
ex 8424 20 00 ex 8424 89 70 ex 9304 00 00	5.1. Pajisje fikse për shpërndarjen e substancave çorientuese ose irrituese në hapësira të mbyllura, të cilat mund të fiksohen në mur ose tavan brenda një ndërtese, përfshijnë një kanistër me agjentë irritues ose çorientues dhe aktivizohen me anë të një sistemi telekomande. Shënim. Ky artikull i referohet pajisjeve të llojit të përdorura në burgje dhe vende të tjera të ndalimit. Nuk ndalon pajisje fikse të dizajnuara për shpërndarjen e substancave verbuese (p.sh. avull uji ose mjegull), që nuk shkaktojnë dëmtime fizike të drejtpërdrejta dhe përdoren në hapësira tregtare ose private, për qëllime parandalimi të vjedhjes.
ex 9301 10 00 ex 9301 20 00 ex 9301 90 00 ex 9302 00 00 ex 9303 10 00 ex 9303 20 10 ex 9303 20 95 ex 9303 30 00 ex 9303 90 00 ex 9304 00 00 ex 9306 21 00 ex 9306 29 00 ex 9306 30 10 ex 9306 30 30 ex 9306 30 90 ex 9306 90 10 ex 9306 90 90	5.2. Pajisje dhe projekte shpërthyes për shpërndarjen e sasisë së dëmshme të agjentëve për kontrollin e trazirave nga platforma ajrore. Shënim. Ky artikull nuk kontrollon granatat e tymit dhe nuk kontrollon platformat ajrore si të tilla. Ky artikull përfshin pajisje, ku mënyra e shpërndarjes është thelbësishme e pasaktë, ose pajisje/projekte që janë në gjendje të shpërndajnë sasi të agjentit të kontrollit të trazirave që janë të dëmshme.

SHTOJCA 2

LISTA E MALLRAVE, QË MUND TË PËRDOREN PËR QËLLIME TORTURE OSE NDËSHKIME MIZORE, ÇNJERËZORE APO POSHTËRUESE

Kodet “NK” në këtë shtojcë i referohen kodeve të specifikuara në Nomenklaturën e Kombinar të Mallrave, bazuar në Sistemin e Harmonizuar Doganor

Në rastin kur pjesa “ex” paraprin kodin “NK”, mallrat e mbuluara nga kjo rregullore përbëjnë vetëm një pjesë të fushës së veprimit të kodit “NK” dhe përcaktohen, si nga përshkrimi në këtë shtojcë edhe nga fusha e veprimit e kodit “NK”.

Shënime

1. Objekti i kontrolleve në këtë shtojcë nuk duhet të përjashtojë eksportet e mallrave të palistuar (përfshirë bimët), që përmbajnë një ose më shumë prej pjesëve të listuara, kur pjesa ose pjesët e kontrolluara janë elementi kryesor i mallrave dhe mund të hiqen ose përdoren praktikisht për qëllime të tjera.

NB: Në vlerësimin, nëse pjesa ose pjesët e kontrolluara duhet të konsiderohen si elementi kryesor, është e nevojshme të peshohen faktorët e sasisë, vlerës dhe njohuritë teknologjike të përfshira, si edhe rrethana të tjera të veçanta, të cilat mund ta klasifikojnë pjesën ose pjesët e kontrolluara, si elementin kryesor të mallrave që po merren.

2. Në disa raste, kimikatet listohen sipas emrit dhe numrit CAS. Lista shtrihet për kimikatet me të njëjtën formulë strukturore (duke përfshirë hidratet), pavarësisht emrit ose numrit CAS. Numrat CAS jepen për të ndihmuar në identifikimin e një kimikati ose përzierje të caktuar, pavarësisht emërimit. Numrat CAS nuk mund të përdoren si identifikues unikë, sepse disa forma të kimikateve të listuara kanë numra të ndryshëm CAS dhe përzierjet që përmbajnë një kimikat të listuar mund të kenë, gjithashtu, numra të tjerë CAS.

Kodi NK	Përshkrimi
	1. Mallrat e disenjuar për të kufizuar qeniet njerëzore, si më poshtë:
ex 7326 90 98	1.1. Pranga
ex 7616 99 90	Shënime:
ex 8301 50 00	1. Prangat janë kufizues, të përbërë nga dy pranga ose unaza me një mekanizëm mbyllës, të lidhura me një zinxhir ose me një shufër.
ex 3926 90 97	2. Ky artikull nuk kontrollon kufizuesit e këmbëve dhe zinxhirët për grupe njerëzish të ndaluar nga artikujt 2.3 dhe 2.4 të shtojcës II.
ex 4203 30 00	3. Ky artikull nuk kontrollon “prangat e zakonshme të duarve”. Prangat e zakonshme të duarve janë ato pranga që përmbushin të gjitha kushtet, si më poshtë:
ex 4203 40 00	- Dimensioni i tyre i përgjithshëm, duke përfshirë zinxhirin, nga ana e jashtme e një prange te ana e jashtme e tjetrës, është midis 150 dhe 280 mm, kur të dyja prangat janë të mbyllura;
ex 4205 00 90	- Perimetri i brendshëm i secilës prangë është maksimumi 165 mm, kur nyja kapet në pikën e fundit që hyn në mekanizmin e mbylljes;
ex 6217 10 00	- Perimetri i brendshëm i secilës prangë është minimumi 200 mm, kur nyja kapet në pikën e parë që hyn në mekanizmin e mbylljes; dhe
ex 6307 90 98	- Prangat nuk janë modifikuar për të shkaktuar dhimbje ose vuajtje fizike.
ex 7315 81 00	
ex 7315 82 00	
ex 7315 89 00	
ex 4017 00 00	
ex 7326 90 98	1.2. Pranga individuale ose unaza të pajisura me mekanizëm kyçjeje, me një perimetër të brendshëm që tejkalon 165 mm, kur nyja kapet në pikën e fundit që hyn në mekanizmin e mbylljes.
ex 7616 99 90	Shënim. Ky artikull përfshin kufizuesit e qafës dhe prangat ose unazat e tjera individuale të pajisura me mekanizëm kyçjeje, të cilat lidhen me prangat e zakonshme të duarve përmes një zinxhiri.
ex 8301 50 00	
ex 3926 90 97	
ex 4203 30 00	
ex 4203 40	

00 ex 4205 00 90 ex 6217 10 00 ex 6307 90 98 ex 4017 00 00	
ex 7326 90 98 ex 7616 99 90 ex 8301 50 00 ex 3926 90 97 ex 4203 30 00 ex 4203 40 00 ex 4205 00 90 ex 6217 10 00 ex 6307 90 98 ex 7315 81 00 ex 7315 82 00 ex 7315 89 00 ex 4017 00 00	1.3. Pranga këmbësh. Shënime: 1. Prangat e këmbëve janë kufizues, të përbërë nga dy pranga, zakonisht prej metali, që vendosen rreth kyçeve të këmbëve dhe lidhen me një zinxhir për t'i dhënë të ndaluarit një lëvizje të kufizuar. Madhësia e prangave është zakonisht më e madhe se ajo e prangave të zakonshme të duarve dhe është e rregullueshme. 2. Ky artikull nuk kontrollon kufizuesit e këmbëve dhe zinxhirët gruporë të ndaluar nga artikujt 2.3, 2.4, 2.5 dhe 2.6 të shtojcës II.
ex 6505 00 10 ex 6505 00 90 ex 6506 91 00 ex 6506 99 10 ex 6506 99 90	1.4. Kapuça për parandalimin e pështyrjes: kapuça, duke përfshirë kapuçat prej rrjete, që mbulojnë gojën dhe parandalojnë pështyrjen. Shënim. Ky artikull përfshin kapuçat për pështyrje, që lidhen me prangat e zakonshme të duarve përmes një zinxhiri.
	2. Armë dhe pajisje të disanjuara për qëllime të zbatimit të ligjit, përfshirë kontrollin e trazirave ose vetëmbrojtjen, si më poshtë:
ex 8543 70 90 ex 9304 00 00	2.1. Armë portative me shkarkim elektrik, që mund të synojnë vetëm një individ, për çdo rast kur administrohet një goditje elektrike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: shkop me shok elektrik, mburoja me shok elektrik, pistoleta trullësë (<i>stun guns</i>) dhe armë me shigjeta me shok elektrik. 1. Shënime: 1. Ky artikull nuk kontrollon rripat elektrohok dhe pajisje të tjera, që hyjnë nën pikën 2.1 të shtojcës II. 2. Ky artikull nuk kontrollon pajisjet individuale elektrohok kur shoqërojnë përdoruesin e tyre për mbrojtjen personale të tij.
ex 8543 90 00 ex 9305 99 00	2.2. Sete që përmbajnë elemente esenciale për bashkimin e armëve portative me shkarkim elektrik të kontrolluara nga artikulli 2.1 Shënim. Mallrat e mëposhtëm konsiderohen të jenë elemente të rëndësishme: - Njësia që prodhon shokun elektrik; - Çelësi, qoftë një telekomandë ose jo; dhe - Elektrodat, ku është e mundur, telat me anë të të cilave administrohet shoku elektrik.
ex 8543 70 90 ex 9304 00 00	2.3 Armët fikse ose të montueshme me shkarkim elektrik, të cilat mbulojnë një zonë të gjerë dhe mund të shënjestrojnë disa individë me shok elektrike.
ex 9303 90 00 ex 9304 00	2.4. Llauzira (lëshues) për projektele me ndikim kinestetik me një të shtënë dhe projektilet përkatëse me ndikim kinestetik (KIP). Shënim. Ky artikull përfshin projektilet që njihen zakonisht si plumba me gomë ose plastikë, fishekë me

00 ex 9306 30 90 ex 9306 90 90	ndikim, projekte irrituese kimike me ndikim dhe thesëza (<i>beanbags</i>). Ato vihen në treg në forma dhe madhësi të ndryshme (topa të mëdhenj dhe të vegjël, cilindër etj.) dhe mund të jenë prej gome, PVC, shkumë të dendur ose druri. Ky artikull nuk kontrollon pajisjet e kontrolluara nga artikujt ML1, ML2 dhe ML12 të Listës së Mallrave Ushtarake.
ex 9301 10 00 ex 9301 20 00 ex 9301 90 00 ex 9302 00 00 ex 9303 10 00 ex 9303 20 10 ex 9303 20 95 ex 9303 30 00 ex 9303 90 00 ex 9304 00 00	2.5. Lëshues dhe pajisje për shpërndarje, përfshirë lëshuesit me shumë barela. Shënim. Ky artikull përfshin lëshues me shumë barela, që zakonisht kanë midis 2 dhe 36 barela, dhe mund të jenë të pavarur (<i>stand-alone</i>) ose të montohen në mjete, përfshirë mjete tokësore pa pilot ose anije detare. Lëshuesit mund të operohen manualisht ose me telekomandë, duke mundësuar qëllim individual, të njëpasnjëshëm ose të përbashkët të goditjes së projekteve me ndikim kinestetik ose irritantëve kimikë, duke sjellë zjarr të shpejtë ose shpërthime zjarri. Ky artikull nuk kontrollon pajisjet e kontrolluara nga artikujt ML1 dhe ML2 të Listës së Mallrave Ushtarake.
ex 9306 21 00 ex 9306 29 00 ex 9306 30 10 ex 9306 30 30 ex 9306 30 90 ex 9306 90 10 ex 9306 90 90	2.6. Municion që përmban projekte të shumta me ndikim kinestetik. Shënim. Ky artikull përfshin municion që mund të jetë prej gome, plastike ose druri dhe ndryshon në madhësi, numër dhe formë. Numri i projekteve në një njësi mund të variojë nga një numër i vogël topash të mëdhenj ose bllokesh deri te qindra pelletë të vegjël. Ky artikull nuk kontrollon pajisjet e kontrolluara nga artikujt ML1 dhe ML2 të Listës së Mallrave Ushtarake
	3. Armë dhe pajisje që përhapin substanca neutralizuese ose irrituese për kontrollin e trazirave ose për vetëmbrojtje dhe substanca të tjera të lidhura me to, si më poshtë:
ex 8424 20 00 ex 8424 89 00 ex 9304 00 00	3.1 Armë dhe pajisje portative, të cilat ose administrojnë një dozë me substanca kimike neutralizuese ose irrituese, të cilat targetojnë një individ, ose përhapin një dozë të një substancë, e cila mbulon një zonë të vogël, për shembull në formë e mjegullës ose resë sprucuese, kur substanca kimike administrohet ose përhapet. Shënime: 1. Ky artikull nuk kontrollon pajisjet e kontrolluar nga artikulli ML7(e) i Listës së Mallrave Ushtarake. 2. Ky artikull nuk kontrollon pajisjet portative, edhe nëse përmbajnë substanca kimike, kur shoqërojnë përdoruesin e tyre për mbrojtje personale të përdoruesit. 3. Gjithashtu, përveç substancave kimike, si për shembull agjentët për kontrollin e trazirave ose PAVA, mallrat e kontrolluar nga artikujt 3.3 dhe 3.4 do të vlerësohen si substanca kimike neutralizuese ose irrituese.
ex 2939 79 90	3.2. <i>Vanillamid acid pelargomic</i> (PAVA) (CAS RN 2444-46-4).
ex 3301 90 30 ex 1302 19 70	3.3. <i>Oleoresin capsicum</i> (OC) (CAS RN 8023-77-6).
ex 3301 90 30 ex 3302 10 90 ex 3302 90 10	3.4. Përzierjet që përmbajnë të paktën 0,3 % në peshë PAVA ose një tretës (si etanol, 1-propanol ose heksan), të cilat mund të administrohen si agjentë neutralizues ose irritues, veçanërisht në aerosolë dhe në lëngje, ose mund të përdoren për prodhimin e agjentëve neutralizues ose irritues. Shënime: 1. Ky artikull nuk kontrollon salcat dhe përgatitjet prej tyre, supat ose përgatitjet prej tyre dhe erëzat e përzierja, nëse PAVA-ja ose OC-ja nuk janë shijet e vetme përbërëse në to.

ex 3302 90 ex 3824 99 92	2. Ky artikull nuk kontrollon produktet mjekësore, për të cilat është dhënë një autorizimin marketingu, sipas legjislacionit të fushës.
ex 8424 20 00 ex 8424 89 70 ex 9304 00 00	3.5. Pajisje fikse ose të montueshme për përhapjen e agentëve çorientues ose irritues, të cilat mbulojnë një sipërfaqe të gjerë dhe nuk janë të dizajnuara për t'u vendosur në mur ose në tavan brenda një ndërtese. Shënim: 1. Ky artikull nuk kontrollon pajisjet e kontrolluara nga neni ML7(e) i Listës së Mallrave Ushtarake 2. Ky artikull përfshin edhe topat e ujit (<i>water cannons</i>). 3. Përveç substancave përkatëse kimike, si agentët për kontrollin e trazirave ose PAVA, mallrat e kontrolluara nga artikujt 3.3 dhe 3.4 do të vlerësohen si substanca kimike çorientuese ose irrituese
ex 9306 21 00 ex 9306 29 00 ex 9306 30 10 ex 9306 30 30 ex 9306 30 90 ex 9306 90 10 ex 9306 90 90	3.6. Projektile me kalibër të madh që përmbajnë agjentë për kontrollin e trazirave. Shënim Ky artikull përfshin projektile që përmbajnë agjentë për kontrollin e trazirave, në veçanti OC dhe PAVA, me kalibër mbi 56 mm. Përdorimi i këtyre artikujve duhet të jetë në përputhje me dispozitat përkatëse të Konventës për Armët Kimike, veçanërisht nenet 2.1 dhe 2.9.d.
ex 2934 99 90 ex 2930 90 95 ex 2933 99 20 ex 2921 29 00 ex 2830 90 85 ex 3824 99 92 ex 3824 99 93 ex 3824 99 96	3.7. Përzierje kimike malodorante, të formuluar për të prodhuar një erë të rëndë dhe të thellë të pakëndshme për qëllime të kontrollit të trazirave, me kusht që të jenë jodëmtuese dhe pa efekte të qëndrueshme shëndetësore. Shënime: 1. Ky artikull përkufizohet si përzierje e destinuar vetëm për qëllime të zbatimit të ligjit, e cila përmban të paktën njërin prej kimikateve të mëposhtme, të formulua për të prodhuar një erë të rëndë e të thellë, të pakëndshme, dhe që mund të shpërndahet me sprai dore, granata, projektile të lëshuara, dronë dhe topa uji: 1) <i>Thioacetone</i> (CAS 4756-05-2) 2) <i>Allicin</i> (CAS 539-86-6) 3) <i>Skatole</i> (CAS 83-34-1) 4) <i>Cadaverine</i> (CAS 462-94-2) 5) <i>Putrescine</i> (CAS 110-60-1) 6) <i>Ammonium hydrosulfide</i> (CAS 12124-99-1) 7) <i>Ethanethiol</i> (CAS 75-08-1) 8) <i>Propanethiol</i> (CAS 107-03-9) 9) <i>Isobutylthiol</i> (CAS 513-44-0) 10) <i>Butanethiol</i> (CAS 109-79-5) 2. Ky artikull nuk kontrollon përzierjet kimike malodorante, që nuk synojnë qëllime të zbatimit të ligjit.

SHTOJCA 3

LISTA E MALLRAVE, QË MUND TË PËRDOREN PËR DËNIMIN ME VDEKJE

Kodi NK	Përshkrimi
	1. Produktet që mund të përdoren për ekzekutimin e qenieve njerëzore me anë të një injeksioni vdekjeprurës janë, si më poshtë:
	1.1. Agjentë anestetikë barbituratë, që veprojnë për një kohë të shkurtër dhe mesatare, ku përfshihen, por pa u kufizuar në:
ex 2933 53 90 [(a) to (f)] ex 2933 59 95 [(g) dhe (h)]	a) <i>amobarbital</i> (CAS RN 57-43-2); b) <i>amobarbital sodium salt</i> (CAS RN 64-43-7); c) <i>pentobarbital</i> (CAS RN 76-74-4); d) kripë natriumi pentobarbital (CAS 57-33-0); e) <i>secobarbital</i> (CAS RN 76-73-3); f) kripë natriumi <i>secobarbital</i> (CAS RN 309-43-3); g) <i>tiopental</i> (CAS RN 76-75-5);

	h) kripë natriumi tiopental (CAS RN 71-73-8), i njohur edhe si natrium tiopenton.
ex 3003 90 00	Shënim. Ky artikull kontrollon edhe produktet, të cilat përmbajnë një nga agjentët anestetik të listuar nën agjentët anestetikë barbituratë, me fuqi vepruese për një kohë të shkurtër ose mesatare.
ex 3004 90 00	
ex 3824 90 96	